

RELACION MBI METODEN E TRAJTIMIT TE MBETJEVE

**IMPIANTI I PERPUNIMIT TE UJRAVE DHE MBETJEVE TE
VAJARAVE, HIDROKARBUREVE (NAFTE APO DHE
HIDROKARBURE TE TJERA)**

PORTO ROMANO,DURRES

INESTITORI: 'SHOQERIA PASTRIMI DETAR' SH.A

PORTO ROMANO

HARTOI: INXH. BARDHYL KONDA

LIC. M0279/1

INXH. Klodjan Pajuni

- **Trajtimi i llumrave me përmbajtje të vogël të mbetjeve të hidrokarbureve apo vajore si dhe sasi të caktuara të naftës bruto**

Përvec trajtimeve të 'lëndëve të para' të përmendura në proceset që kryhen në impiantet e abjeneteve tona të cilat janë të njohura nga AKM për të cilat kemi marrë dhe leje mjedisore e ne mund të trajtojmë dhe llumra me një përmbajtje jo shumë të lartë të lëndës së ngurtë dhe të mbetjeve të hidrokarbureve, vajrave apo dhe të naftës bruto (suspension me përqëndrim deri në 30% të lëndës së ngurtë). Mënyra e trajtimit të tyre është e tillë ku ndërthuren në hapa të ndryshëm impianti i ujit dhe i distilimit (rafinimit). Filimisht merren llumrat që kanë një fluiditet të lartë dhe mbetjet përkatëse me përmbajtje të njohur ose jo dhe me pasë kalon në një depozit vertikale me kapacitet mbi 30 m³ dhe trajtohet me demulgatorë në raportë nga 1-2 kg demulgator per 10000 litra ku kemi suspension (pezulli) të lëndës së ngurtë në fazën ujore pr njëkohësisht mund të kemi dhe emulsion të hidrokarbureve në fazën ujore dhe trajtohen në temperaturë 70-90°C. Gjatë këtij trajtimi behet prishja e emulsionit dhe kemi një ndarje fazore me tri shtresa të cilat janë : në fundin e depozitës kemi fazën e llumit në shtresën e mesme është faza ujore dhe në atë të sipërme ajo hidrokarbure, vajore apo nafta bruto. Ky lloj shtresëzimi nuk është i ndarë në mënyrë perfekte pasi midis shtresave kemi përzjerje të fazave me njëra –tjetrën.

Pasi kjo masë e nxehur në këto temperature ftohet pra arrinë temperaturën e mjedisit ku ndarja fazore është e dukshme. Më pas këto faza kalojnë në etapën tjetër atë të trajtimit të mëtejshme e cila behet në dy impiantet e sipërpërmendura. Faza e rënd së bashku me atë ujore kalojnë përzihen mirë me njëra tjetrën dhe kalojnë në impiantin e përpunimit të ujit ku i nënshtrohen gjatë fazës së trajtimit me hipoklorit natriumi ndodh dhe nje oksidimit i lehte i një pjese të komponentëve organik që janë në sasi të papërfisllshme dhe atyre inorganik, gjatë trajtiit me karbon aktiv një pjesë e komponentëve jo polar adsorbohen nga karboni aktiv . Trajtimi me acid bën defosfatizimin dhe denitrifikim të pjeshëm por gjithashtu ndihmon në formimin e precipitateve te joneve te kalciumit apo dhe te tjere qe formojnë sulfate te patretshme, gjithashtu krijon dhe pH e duhur te veprimit të të karbonit aktiv me disa komponentë organic që në një pH të caktuar janë në

form jonik ndërsa në një vlerë të caktuar janë neutral (dhe apolar). Trajtimi me bazë bën neutralizimin e acidit të tepërt por dhe demineralizimin e ujit. Një tjetër hap i trajtimit është dhe trajtimi me poliklorur alumini i cili përvec karakterit të flokulantit ka një dhe një veti tjetër të rëndësishme që në një pH të caktuar (rregulluar nga hedhja e acidit) ato komponent organik aromatik apo alifitik nëpërmjet reaksionetve të Fridel-Krafts bën të mundur formimin e makro strukturave organike dhe lehtëson adsorbimin të karboni aktiv dhe lehtëson ndarjen nga faze ujore. Trajtimi fundor kimik bëhet me polielektrolitin organik i cili është një flokulant shumë i fuqishëm dhe bën që të gjithë komponentët e rënd dhe jopolar të formojnë agregate dhe të sedimentojnë në fundë të tankut të sedimentimit. Këto sedimente kalojnë në filtër pres ku bëhet presimi dhe dehidratimi pothuajse i plot i tij. Kjo sasi e përfutur pas presimit në filtër pres grumbullohet dhe më pas mund të depozitohet në landfille specifike që e kanë të lejueshme depozitimin e tyre, nëse jo atëherë këto mbetje mund të çohen në impiantet e incenerimit të cilët bëjnë një trajtim në temperaturë të lartë, dhe më pas këto mbetje të përfutur pas këtij trajtimi mund të depozitohen në çfarëdoq landfilli, pasi konsiderohen në gjendje të qëndrueshme dhe nuk ka rrezik ndotje të mjedisit. Përsa i përket pjesës së sipërme të mbetjeve hidrokarbure, vajore apo dhe ajo sasi e vogël e naftës bruto kalonë në impiantin e përpunimit (distilimit). Kjo sasi përzihet me një sasi tjetër mbetjeje me viskozitet të ulët në mënyrë që të lehtësoj procesin e përzierjes gjatë trajtimit. Gjatë distilimit produktet janë të ngjashme me ato të përmendura në procesin e rafinimit. Mbetja e ngelur në distilator por dhe produktet e tjera i nënshtrohen analizave, në bazë të të cilave lejohet përdorimi ashtu sic janë ose do shërbejnë si lëndë e parë në proceset e tjera të industrive të përpunimit të naftës dhe hidrokarbureve në vendin ton për prodhim bitumi, diezeli, benzine etj. Gjithashtu duhet theksuar që ato mbetje që dalin pasë fazës së parë mund të mos trajtohen në impiantin ton por në impiante të tjera të specializur kjo bëhet në varësi të leverdishmërisë ekonomike për trajtim të mëtejshëm në impiantin ton apo jo, sigurisht dhe nga aspektet teknike të trajtimit.